# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-472456**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Polici dhe protesta, njësoj si në Tiranë”/ Rama nga SHBA: Njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë, shefi ishte shqiptar |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/26/polici-dhe-protesta-njesoj-si-ne-tirane-rama-nga-shba-njeri-kishte-ardhur-nga-britania-per-te-me-gjuajtur-me-veze-shefi-ishte-shqiptar65654654/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 19:08:10 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 26 shtator 2026, 18:29:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 26 shtator 2026, 18:28:00 UTC → 26 shtator 2026, 18:30:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ac59630f8469ac2c014d79ceed8250d65d369904a60134efce8da12aec848413` |
| TEKSTI | `dc34e32de2a4da7fc35ec17eefe64ec164881ddac65ef55c029723de0abf1911` |
| PAMJA | `e24a02e29bc8d640da2b31dadee5635e513264a75350760f4a4d3f82dcc63cbf` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `061148db4b1ce2eb63811a31494d6f10f3430df9d953deacdd44d8285dac72e4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/061148db4b1ce2eb63811a31494d6f10f3430df9d953deacdd44d8285dac72e4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# "Polici dhe protesta, njësoj si në Tiranë"/ Rama nga SHBA: Njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë, shefi ishte shqiptar

26/09/2026 20:29



**Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim me komunitetin shqiptar në Staten Island, New York, ku foli për lidhjen mes Shqipërisë dhe diasporës.**

Në fjalën e tij, Rama vlerësoi kontributin e emigrantëve shqiptarë ndër vite dhe theksoi se marrëdhënia me diasporën tashmë ka kaluar nga dërgesat financiare te një partneritet më i gjerë.

Ai përmendi investimet, ekspertizën dhe rikthimin e shqiptarëve në atdhe, si edhe Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2030. Me tone humori, Rama foli edhe për protestën me vezë ndaj tij pak ditë më parë në New York. Në fund, kryeministri u ndal te prania dhe roli i komunitetit shqiptar në jetën e SHBA-së.

"Shumë faleminderit të gjithëve për këtë mikpritje! Me thënë të drejtën, kur më thanë mbrëmë që një "big storm" ishte duke ardhur, menduam se do të ishte një pengesë për ju që të mblidheshit këtu, por mesa duket, ju jo vetëm u mblodhët, por ndaluat dhe storm-in të bënte ato që parashikoheshin.

Dhe më vjen shumë mirë që jam këtu në Staten Island, ku thonë se është i vetmi vend në botë, ku mund të gjesh Ismail Qemalin, Isa Boletinin dhe Franklin Roosevelt, që janë krah për krah njëri-tjetrit, çka tregon se, pavarësisht se këtu jemi në Amerikë, ky është një territor jo zyrtarisht i pushtuar nga shqiptarët.

Më vjen shumë mirë po ashtu që jemi këtu sot për të ndarë disa gjëra që kanë ndodhur në këto vite, qysh se pikërisht këtu në Staten Island, në vitin 2015, unë isha në një darkë shqiptarësh, i ftuar së bashku me Hashim Thaçin, dhe në atë darkë u diskutua për herë të parë ideja e atij që 1 vit më pas u bë Samiti i parë i Diasporës në Tiranë, ku ishim së bashku me Hashim Thaçin dhe në 10 vjet prej atij samiti besoj se kanë ndodhur plot gjëra pozitive dhe lidhja e Shqipërisë me diasporën dhe e diasporës me Shqipërinë, që deri asaj kohe lidhej vetëm me dërgesat, që të gjithë emigrantët shqiptarë çonin në Shqipëri për të ndihmuar familjet që t'i mbijetonin vështirësive, është kthyer në një lidhje ku shumëçka tjetër ndodh dhe ku janë ngritur ura nëpër të cilat kalojnë interesa, kalojnë investime, kalojnë dhe plot rikthime shqiptarësh në tokën amë, qoftë për të bashkëfinancuar me miq dhe të afërm projekte të ndryshme, por qoftë edhe për të qëndruar në Shqipëri.

Në këto vite ka një fakt të jashtëzakonshëm që i bën një nder të madh diasporës shqiptare dhe që e vendos çdo emigrant shqiptar në një piedestal të posaçëm të historisë sonë. Fakti është se 90% e familjeve shqiptare kanë përfituar të paktën një


## Kryesore



Aksident i rëndë në Thumanë, tre mjete përplasen me njëra-tjetrën, humb jetën një 19-vjeçar, plagosen dhe dy persona
07:38

SPAK aksion në Shkodër e Tiranë për arrestimin e personave me rrezikshmëri të lartë, një në pranga, Endrit Dokle shpallet sërish në kërkim
10:57

Atentat në Athinë, katër persona hapën zjarr drejt një kafeneje, plagoset një fëmijë shqiptar
07:59

Teherani ofroi armëpushim 7-ditor, Wall Street Journal: Trump e refuzoi dhe kërkoi që bombardimet ndaj Iranit të vijojnë pas zgjedhjeve të nëntorit
08:12

## Më të lexuarat

Pushimet kthehen në tragjedi, motër e vëlla nga Shqipëria dhe partnerët e tyre humbin jetën pas shembjes së godinës në Athinë

Statusi i Saimir Tahirit në Facebook, miqtë e tij tregojnë për Top Channel çfarë pritet të thotë ish-ministri i brendshëm socialist

Fusha kthehet në ring! Lukaku bën gjestin e turpshëm ndaj italianëve, Donnarumma humb toruan dhe vërsulet drejt tij

Shpërthimi i fuqishëm në Athinë ku humbën jetën 3 shqiptarë, ekipet e emergjencës nxjerrin trupat e 6 viktimave nga rrënojat

Berisha pa ftesë për ceremoninë e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, kreu i PD: Nuk jam ftuar as për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

Ekskluzive/ Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i komunikon akuzën autorit Elvis Shkambi

Ish-agjenti i CIA u sugjeron amerikanëve të jetojnë në Shqipëri, Bustamante: Nëse do të doja të zhvendosesha në Evropë, Shqipëria do të ishte në radarët e mi

U arrestua me urdhër të SPAK, kush është 50-vjeçari që njihet si "i forti i Shkodrës", pjesë edhe e grupit 'Rraja'

"Disa histori i kam jetuar, të tjera...", çfarë po paralajmëron ish-ministri Tahiri, publikon videon 'enigmatike': Kam shumë për të thënë

herë nga dërgesat financiare të diasporës dhe 9 në 10 shqiptarë janë shkolluar, kanë ngritur çatinë mbi kokë apo e kanë përmirësuar jetën e tyre falë jush, falë çdo familjari, të afërmi, miku që i është gjendur në ditë të vështira. Dhe ky është një nder i madh që do ta mbulojë me lavdi diasporën shqiptare të gjithë këtyre viteve.

Siç e thashë, nuk jemi më në atë fazë kur diaspora jepte, Shqipëria merrte dhe marrëdhënia mbaronte aty. Jemi në një fazë tjetër, kur diaspora nuk është vetëm kujtesë, nostalgji, solidaritet, por është edhe një lidhje gjithmonë e më e fortë dhe një partneritet, i cili ka hyrë në rrugën e një zhvillimi dhe ku sot kemi organe të një trupi krejt të ri që kemi ndërtuar, institucionet e diasporës, këshillat koordinues, agjencitë që luajnë rolin e urave dhe nga ana tjetër, samitet të cilat ndihmojnë për të bërë bilance dhe për të marrë përsipër angazhime.

Nga Samiti i fundit i Diasporës ne dolëm me një strategji kombëtare të diasporës 2030, e cila ka në përbërjen e vet, në përmbajtjen e vet, qeverisjen dhe shërbimet, dialogun dhe ekspertizën e diasporës, ekonominë dhe inovacionin, si dhe gjuhën dhe kulturën për më të vegjlit.

Kemi nisur të krijojmë një regjistër kombëtar të diasporës si një dritare për të gjithë ata që duan të investojnë sadopak apo sadoshumë në Shqipëri. Ajo që është më e rëndësishmja është se ky ndryshim që ka ndodhur në këtë marrëdhënie, nuk ka ndodhur thjeshtë aty ku ta rrok syri, por ka ndodhur në mendësi, ka ndodhur në atë që sot është një marrëdhënie shumë gjithëpërfshirëse, shumë organike dhe pjesë e këtij organiciteti ishin dhe vezët që m'u hodhën mua para pak netësh, të cilat treguan se jeta aktive shqiptare dhe jeta me Shqipërinë politike dhe me zhvillimet në Shqipëri, është diçka që tanimë i ka integruar bashkë shqiptarët në Shqipëri dhe shqiptarët kudo ku ndodhen. Madje një nga hedhësit e vezëve kishte ardhur nga Anglia për të hedhur vezë. Mund të kishte ardhur edhe në Tiranë, por preferoi të vinte në New York dhe me këtë rast, shpresoj të ketë kaluar mirë edhe me Policinë e New Yorkut.

Ndërkohë që, nga ana tjetër, ishte shumë e bukur që në trupën e mbrojtjes që u angazhua pastaj për çdo eventualitet, kryesori ishte një shqiptar që shërben në Policinë e New Yorkut. Kështu që, falë këtij integrimit të madh të shqiptarëve në jetën e këtij vendi dhe falë edhe interesimit të madh të shqiptarëve për jetën e atij vendi, unë u ndodha komplet në shtëpi. Edhe policia, edhe protestuesit, njësoj si në Shqipëri. Super!

Dhe për ta bërë komplet spektakolare këtë pamje integrimi, u mirëprita këtu nga Xhemoja dhe nga organizatorët me një tortë rozë që kishte dy flamingo si një zemër dhe më erdhi jashtëzakonisht mirë për vete, për flamingot, për Xhemon, për të gjithë, sepse jetojmë në një kohë kur Shqipëria tanimë nuk vuan më faktin e tmerrshëm se zogjtë e kafshët e njerëzit vriten dhe askush nuk merret me to, por jeton në një kohë kur shqetësohet për zogjtë, shqetësohet për gjethet, shqetësohet për fluturat, shqetësohet për ujin, shqetësohet për biodiversitetin, njësoj si në çdo vend kur problematikat e mëdha të mbijetesës janë kapërcyer dhe kanë filluar problematikat e mëdha të zhvillimit dhe koha kur Shqipëria mendonte ka edhe më keq, ishte koha kur ne nisëm së bashku këtë rrugëtim dhe falë këtij rrugëtimi, ka ardhur koha kur Shqipëria thotë ka edhe më mirë dhe kjo është sfida jonë e përditshme, sepse është e vërtetë, ka edhe më mirë dhe është plotësisht e vërtetë që ne së bashku mund të bëjmë çdo ditë e më mirë për Shqipërinë, për shqiptarët.

Duke qenë se këtu me mua, pasi pa që më hodhën disa vezë, erdhi me urgjencë kryepolici i Shqipërisë, Pjerin Ndreu dhe duke qenë se Pjerini, si një ndër kryetarët më të suksesshëm të bashkive të Shqipërisë, edhe pse nuk e thotë, jeton me vuajtjen e madhe që pse Lezha nuk është kryeqytet, më tha që bëj kujdes se këtu në sallë ka korçarë, ka mallakastriotë, ka vlonjatë, okej, të gjitha, por këtu në sallë ka lezhjanë dhe ti duhet të thuash diçka për ta. Çfarë të them unë për lezhjanët, përveçse lum si ju që keni Pjerin Ndreun dhe lum si Pjerin Ndreu që ju ka juve", tha Rama mes të tjerash.

**Top Channel**

**Detaje/ Atentati në Athinë ku mbeti e plagosur 10-vjeçarja shqiptare, urdhri u dha nga i burgosuri 'i famshëm', babai i të miturës pronar i lokalit**

## Kryesore »







LIVE Shqipëri-Bjellorusi/ Nis sfida në "Air Albania", Kombëtarja kërkon triumfin pas pesë humbjeve radhazi

26/09 20:46

"Paketa e Maleve është për pronarët"/ Kryeministri Rama nga Nju Jorku: Zvërneci sjell 4 miliardë euro, po studiojmë ndikimin dhe riskun në mjedis

26/09 20:46

Ekskluzive/ Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i komunikon akuzën autorit Elvis Shkambi

26/09 20:07



"Humori, Parlamenti apo qeveria: Kush të bën të qeshësh më shumë?"

26/09 19:07




Nis protesta e 119-të kundër qeverisë në Tiranë, tubuesit grumbullohen në sheshin "Skënderbej" dhe marshojnë drejt Kryeministrisë

26/09 19:00



Zjarr pranë tunelit të Krrabës, flakët përfshijnë dhe djegin plotësisht një autobus

26/09 18:25

## Politikë »



"Paketa e Maleve është për pronarët"/ Kryeministri Rama nga Nju Jorku: Zvërneci sjell 4 miliardë euro, po studiojmë ndikimin dhe riskun në mjedis

26/09 20:46



Instituti i ri për të miturit, ministri Gogu nga Abu Dhabi: Fëmija do të jetë në qendër, fokusi te arsimi dhe riintegrimi

26/09 19:45



Erion Braçe reagon pas debatit me aktivisten: Ndërpreu takimin, nisi të shajë, të fyejë e deri të mallkojë banorët

26/09 18:03



Ambasadori i ri i SHBA i dorëzoi Letrat Kredenciale, Begaj pas takimit kokë më kokë me Wendt: Do vijojmë forcimin e partneritetit me Amerikën

26/09 14:17



Ministri Hoxha nënshkruan Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit Kibernetik: Siguria pjesë e agjendës kombëtare të transformimit dixhital të Shqipërisë

26/09 13:24



Berisha pa ftesë për ceremoninë e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, kreu i PD: Nuk jam ftuar as për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

26/09 12:57

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News- Trump paralajmëroi Kinën për Iranin/ Prapaskenat e takimit me Xi Jinping, zbardhen detajet



Top Channel/ "Vezë, protestë dhe flamingo, u ndjeva si në Tiranë", Rama nga SHBA: Kishte ardhur nga...



Top News – Mbesa sekrete e Putinit/ Elsa, e lindur me mbiemrin Zelensky, por e "pagëzuar" Tikhonova







**Top Channel/ Rama me batuta për burrat shqiptarë në New York: Në zemër dridhen nga frika**

**Top Channel/ “4 miliardë euro”, Rama nga New York-u: Zverneci e Sazani, projekt i jashtëzakonshëm**

**Top Channel/ “Diaspora e rëndësishme”, Rama nga New York-u: Erdhi nga Anglia për të më hedhur vezë**

## Lajme

- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

## Bota

- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

## Sport

- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

## Pop News

- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

## Programe

- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

## Top Channel

- Rreth Top Channel
- Kontakt
- Bileta – Portokalli
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksesueshmëria

**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.